



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:067097

Datë: 15.03.2024

Numri i dokumentit: 05459613

C.nr.619/21

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ- DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM-DIVIZIONI CIVIL, gjyqtarja Kreshnike Zymberi Beqiri, me bashkëpunëtoren profesionale Ilirjana Hashani, në çështjen juridike kontestimore sipas padisë së paditësve M. R.Q., G.I., M. S., B. H. dhe D. M. të gjithë me vendbanim në Komunën e Shtimes, të cilët i përfaqëson me autorizim av. Labinot Buzuku nga Prishtina, e paraqitur kundër të paditurës Komuna Shtimes - Drejtoria e Arsimit, në çështjen juridike kompensim i të ardhurave në emër të udhëtimit dhe kualifikimit, jashtë seancës së shqyrtimit gjyqësor me datë 15 mars 2024, përpiloi me shkrim këtë:

A K T G J Y K I M

-pa shqyrtim kryesor të çështjes-

- I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësve M.R. Q.G. I., M. S., B. H. dhe D. M.ashtu që DETYROHET e paditura Komuna Shtime - Drejtoria e Arsimit, që paditëseve në emër të kompensimit të të ardhurave në emër të inflacionit, udhëtimit dhe diferencës për kualifikim të ua kompensoj shuma si në vijim;

1. Paditëses M. R.Q.:

- a) Në emër të shpenzimeve të udhëtimit për 414 ditë pune për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 11.03.2020 në vlerë të 70% të biletës së udhëtimit, shumën prej 289.80€ (dyqind e tetëdhjetë e nëntë euro e tetëdhjetë cent);
- b) Në emër të pagesës shtesë përqindjes së inflacionit për periudhën kohore për muajt Qershor- Dhjetor të vitit 2019 në shkallën e inflacionit prej 2.7% shumën prej 79.00 €, për muajt Janar- Dhjetor të vitit 2020 në shkallën e inflacionit prej 0,2% shumën prej 10.10 €, për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e

inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.77 € dhe për muajt Janar – Tetor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 488.36 €, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në shumë të përgjithshme prej 749.23 € (shtatëqind e dyzetë e nëntë euro e njëzetë e tre cent).

- c) Për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 31.01.2023, për 61 muaj, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në emër të drejtës së licencimit-gradimit në lartësi prej 27%, në shumë prej 3,355.00€ (tremijë e treqind e pesëdhjetë e pesë euro);

2. Paditëses G.I. :

- a) Ne emër te shpenzimeve të udhëtimiti për 536 ditë pune për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 11.03.2020 në vlerë të 70% të biletës së udhëtimit, shumën prej 375.20€ (treqind e shtatëdhjetë e pesë euro e njëzetë cent);
- b) Në emër të pagesës shtesë përqindjes së inflacionit per periudhën kohore për muajt Qershor- Dhjetor të vitit 2019 në shkallën e inflacionit prej 2.7% shumën prej 79.00 €, per muajt Janar- Dhjetor të vitit 2020 në shkallën e inflacionit prej 0,2% shumën prej 10.10 €, për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.77 € dhe për muajt Janar – Tetor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 488.36 €, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në shumë të përgjithshme prej 749.23€ (shtatëqind e dyzetë e nëntë euro e njëzetë e tre cent);
- c) Për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 31.01.2023, për 61 muaj, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në emër të drejtës së licencimit-gradimit në lartësi prej 27%, në shumë prej 3,355.00€ (tremijë e treqind e pesëdhjetë e pesë euro);

3. Paditësit M. S.:

- a) Ne emër te shpenzimeve të udhëtimiti për 536 ditë pune për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 11.03.2020 në vlerë të 70% të biletës së udhëtimit, shumën prej 375.20€ (treqind e shtatëdhjetë e pesë euro e njëzetë cent);
- b) Në emër të pagesës shtesë përqindjes së inflacionit per periudhën kohore për muajt Qershor- Dhjetor të vitit 2019 në shkallën e inflacionit prej 2.7% shumën prej 79.00 €, per muajt Janar- Dhjetor të vitit 2020 në shkallën e inflacionit prej 0,2% shumën prej 10.10 €, për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e

inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.77 € dhe për muajt Janar – Tetor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 488.36 €, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në shumë të përgjithshme prej 749.23€ (shtatëqind e dyzetë e nëntë euro e njëzetë e tre cent).

- c) Për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 31.01.2023, për 61 muaj, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në emër të drejtës së licencimit-gradimit në lartësi prej 27%, në shumë prej 3,355.00€ (tremijë e treqind e pesëdhjetë e pesë euro);

4. Paditëses B. H.;

- a) Ne emër te shpenzimeve të udhëtimiti për 536 ditë pune për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 11.03.2020 në vlerë të 70% të biletës së udhëtimit, shumën prej 375.20€ (treqind e shtatëdhjetë e pesë euro e njëzetë cent);
- b) Në emër të pagesës shtesë përqindjes së inflacionit per periudhën kohore për muajt Qershor- Dhjetor të vitit 2019 në shkallën e inflacionit prej 2.7% shumën prej 79.00 €, per muajt Janar- Dhjetor të vitit 2020 në shkallën e inflacionit prej 0,2% shumën prej 10.10 €, për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.77 € dhe për muajt Janar – Tetor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 488.36 €, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në shumë të përgjithshme prej 749.23€ (shtatëqind e dyzetë e nëntë euro e njëzetë e tre cent).
- c) Për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 31.01.2023, për 61 muaj, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në emër të drejtës së licencimit-gradimit në lartësi prej 27%, në shumë prej 3,355.00€ (tremijë e treqind e pesëdhjetë e pesë euro);

5. Paditëses D. M.:

- a. Ne emër te shpenzimeve të udhëtimiti për 177 ditë pune për periudhën nga data 18.04.2017 deri më 11.03.2020 në vlerë të 70% të biletës së udhëtimit, shumën prej 81.90€ (tetëdhjetë e një euro e nëntëdhjete cent);
- b. Në emër të pagesës shtesë përqindjes së inflacionit për periudhën kohore për muajt Qershor- Dhjetor të vitit 2019 në shkallën e inflacionit prej 2.7% shumën prej 79.00 €, për muajt Janar- Dhjetor të vitit 2020 në shkallën e inflacionit prej 0,2% shumën prej 10.10 €, për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e

inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.77 € dhe për muajt Janar – Tetor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 488.36 €, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në shumë të përgjithshme prej 749.23 € (shtatëqind e dyzetë e nëntë euro e njëzetë e tre cent).

- c. për periudhën nga data 01.01.2018 deri më 31.01.2023, për 61 muaj, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në emër të drejtës së licencimit-gradimit në lartësi prej 27%, në shumë prej 3,355.00€ (tremijë e treqind e pesëdhjetë e pesë euro);

Të gjitha këto secilës paditëse veç e veç të ua paguaj me kamat ligjore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë deri përmbushjen definitive, në afat prej 7 dite nga plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore - përmbarimit të detyrueshëm.

- II. DETYROHET e paditura që paditësve të ua kompensojë shpenzimet e procedurës në shumë prej 498.00€ (katërqind e nëntëdhjetë e tetë euro), të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore - përmbarimit të detyrueshëm.
- III. OBLIGOHEN paditëset që të paguaj taksën gjyqësore për parashtrimin e padisë në shumë prej 20.00€ (njëzetë euro) në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, nën kërcënimin e pasojave ligjore- përmbarimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m

Paditëset përmes të autorizuarit të tyre me date 13.04.2021 pranë kësaj gjykate kanë parashtruar padi me të cilën kanë kërkuar kompensimin mbi bazën juridike të inflacionit ,kompensimit për licencim dhe udhëtimit si dhome date 14.12.2023 prane kesaj gjykate ka dorezuar precizimin e saj me të cilën ka kërkuar kompensimin ,per udhetim ,diferences per kualifikim - licencim si dhe inflacionit në bazë të përqindjes së inflacionit per vitin 2019 për periudhën qershor – dhjetor në përqindje 2.7% shumën prej 79.00 €,per vitin 2020 për muajt Janar – Dhjetor në shkallën e inflacionit prej 0,2% shumën prej 10.10 €, për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.76 € dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 488.36 €, e qe ne shume te pergjitheshme per secilen vceq e veq nga 749.23 euro, ndersa ka kerkuar qe të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë per

secilen sipas shumava te kerkuara si ne precizim dhe ate per secilen veq e veq si ne precizim dhe atë të gjitha me kamatë ligjore prej 8%, e cila fillon të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës në afat prej 7 dite nga plotëfuqishmëria e këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit me dhunë.

E paditura në përgjigjen në padi e ka kundërshtuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëse është e pabazuar pasi që kontrata kolektive e nënshkruar më dt. 17.04.2017 nuk është më në fuqi ndërsa sipas ligjit të punës kërkesëpadia e paditësit është e parashkruar. Kontrata kolektive ka paraparë që shkalla e inflacionit sipas entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja e saj të futet në pagë dhe kompetente për llogaritjen dhe përfshirjen e inflacionit në page është enti i Statistikave të Kosovës. I ka propozuar gjykatës që të refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Si dhe tutje ne përgjigje ne padi e paditura e ka kontestuar kërkesa padinë duke shtuar se e njëjta është çështje e gjykuar , me te cilën e ka bashkangjitur edhe aktgjykimin me numër C.nr...., me te cilën G.I.dhe M. S. dhe D. M. janë kompensuar për këto qeshtje .

Gjykata pas pranimit të përgjigjes në padi ka çmuar se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me nenin 398 dhe 399 lidhur me nenin 143 të LPK-së, pasi konstatoi se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadiës dhe se ka vlerësuar se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, e që në rastin konkret ka rezultuar se kërkesëpadia e paditësve është e bazuar.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 398 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*. Andaj, bazuar në dispozitat e nenit 398 të LPK-së, Gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë pa caktuar seancë gjyqësore, pasi që vlerësoi se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësve është qartazi e themeltë pasi që bazohet në dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, ndërsa shumat e kompensimit vërtetohen nga provat që gjenden në shkresat e lëndës.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, si mësimdhënëse në institucionet shkollore në Shtime, e që ky fakt gjen edhe mbështetje në bazë të kontratave të punës me numër 05/201 e datës 14.01.2016 ne emër te paditëses se pare M. R. Q. dhe vërtetimi mbi ditët e pranisë ne pune me numër 96/2020 i datës 04.06.2020, licenca me numër 100020843, kontrata me numër 05/431 e datës 29.03.2016 ne emër te paditëses se dyte G. I.licenca me numër 100007057, vërtetimi mbi ditet e pranisë ne pune me numër protokolli 62/2020 i datës 104.06.2020 kontrata me numër protokolli 05/439 e datës 30.08.2017 ne emër te paditësit M. S.vërtetimi me numer protokoli 63/2020 i dates 04.06.2020 ,licenca me numer 100007428 ,kontrata me numer protokoli 05/314/150 ne emer te paditeses B.H. si dhe vertetimi mbi ditet e pranise ne pune i dates 65/2020 i dates 04.06.2020 ,licenca me numer 1028269, paditeses D. M. kontrata e punes me numer 05/444/13 e dates 02.09.2019 , si dhe vertetimi mbi ditet e pranise ne pune i dates 81/2020 i dates 04.06.2020 licenca me numer 1030500 dhe si dhe nuk është kontestuese se paditëset gjendet në listën e pagave dhe kanë pagën bazë 421euro, si dhe kuponet fiskal te biletave te autobusit per udhetime ne destinacionet nga vendbanimet e tyre.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigjen në padi, Gjykata ka vlerësuar se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë është bazuar në faktin se me Kontratat Kolektive të nënshkruara nga Qeveria e Kosovës-Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë, për punëmarrësin Bashkimin i Sindikatave të Pavarura të Kosovës e cila është nënshkruar nga ana e dy palëve dhe në neni 49 respektivisht me nenin 48 të këtyre kontratave është përcaktuar se këto kontrata hynë në fuqi me ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Në pjesën hyrëse respektivisht në nenin 1 të kontratës kolektive është e përcaktuar qartë se kush përfiton nga kontrata kolektive e që në rastin konkret paditëset e kanë shfrytëzuar këtë të drejtë dhe të njëjtat përfitojnë nga kjo e drejtë, për faktin se me Kontratën Kolektive të datës 18.04.2017 respektivisht atë të datës 22.01.2021, në nenin 35.10 thuhet “Për çdo vit përcillet shkalla e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës dhe përqindja (%) e inflacionit të futet në pagë”, ku gjykata pas analizimit të shkresave të lëndës respektivisht listave të pagave ka

gjetur se shkalla e inflacionit sipas viteve përkatëse nuk rezulton të jetë futu në pagë si pagesë shtesë, e që rrjedhimisht nënkupton se ka lindur detyrimi i të paditurës për të kompensuar këtë diferencë në pagë sipas viteve përkatëse.

Gjykata sa i përket aprovimit të lartësisë kërkesëpadisë në lidhje me shkallën e inflacionit e ka bazuar në të dhëna zyrtare të Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës përmes faqes zyrtare dhe atë bazuar në këto të dhëna rezulton se, mesatarja vjetore e inflacionit sipas Entit të Statistikave të Republikës së Kosovës, për vitin 2019 ka qenë në shkallë prej 2,7%, për vitin 2020 ka qenë në shkallë prej 0,2%, për vitin 2021 ka qenë në shkallë prej 3,4% ndërsa për vitin 2022 ka qenë në shkallë prej 11,6%.

Më tutje, bazuar në këtë mesatare të shkallës së inflacionit, gjykata ju ka njohur secilës paditësve veç e veç të drejtën në kompensim në emër të inflacionit dhe atë për muajt Qershor- Dhjetor të vitit 2019 në shkallën e inflacionit prej 2,7% prej 79.00 €, per muajt Janar-Dhjetor të vitit 2020 në shkallën e inflacionit prej 0,2% shumën prej 10.10 €, për muajt Janar – Dhjetor të vitit 2021 në shkallën e inflacionit prej 3.4% shumën prej 171.76 € dhe për muajt Janar – Nëntor të vitit 2022 në shkallën e inflacionit prej 11.6% shumën prej 488.36 €, të i kompensojë diferencën e papaguar në pagë në shumë të përgjithshme prej 749.23€, duke u llogaritur këtë shkallë të inflacionit në pagën bazë prej 421.00€, andaj bazuar në këtë gjykata ka gjykuar shumat si në pikën II të dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sa i përket kërkeses lidhur me të drejtën e kompensimit në emër të kualifikimit, gjykata ka gjetur se rastin konkret zbatohen dispozitat e Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33 të datës 29.08.2008. Kështu, në pikën 1. të këtij vendimi, përcaktohet që *“nga 1 shtatori 2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës, do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*. Ndërsa, në pikën 4. të vendimit në fjalë parashihet ngritja e pagës sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit, në të cilën përcaktohet se *“mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur: 1). Me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%; 2). Me diplomë të Shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%; 3). Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27% dhe 4). Me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”*. Më tutje kjo e drejtë e paditëses është fuqizuar edhe me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër

214/2023 të datës 09.10.2023, në pikën I. të tij përcaktohet që *“për kërkesat e mësimdhënësve për kompensim mbi bazën e kualifikimit (licencimit), kompensimi bëhet sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008”*, vendim i cili ka qenë në fuqi deri më 06.02.2023.

Në rastin konkret, gjykata gjeti se e paditura ka për detyrim, që paditëses se trete t’ia bëjë kompensimin mbi bazën e kualifikimit ose licencimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës, me nr.01/33, datë 29.08.2008, sipas shkallës apo nivelit të kualifikimit ose licencimit të përcaktuar në këtë vendim. Më konkretisht, nga lista e pagave të lëshuar nga Buxheti i Republikës së Kosovës dhe kontratave të punës ka rezultuar se e paditura, në emër të kualifikimit apo licencimit në pagën bazë, ua ka paguar shumën prej 58.32 euro, ku me ç’rast ka pasur për detyrim të i paguaj shumën prej 113.67€ apo në lartësi prej 27% të pagës bazë, andaj bazur në këtë e paditura paditëseve u ka mbetur borxh për çdo muaj shumën prej 55.00 euro apo diferencën e mbetur te vlerës për sa do ti takonte kompensimi prej 27% apo në shume prej 113.67€, e që i bje se për secilin paditës te specifikuar si me lart për muajt veq e veq dhe ate nga data 01.01.2018 deri më datë 31.01.2023 u ka mbetur borxh seciles në shumë të përgjithshme prej 3,355.00 €.

Po ashtu në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, të datës 22.01.2021, e më saktësisht në dispozitën 35 paragrafi 7, të KKAK-së është paraparë se e paditura ka pasur për detyrim që paditësve si mësimdhënëse t’ia paguaj kompensimin për ushqimin gjatë punës dhe shpenzimet e udhëtimit në vlerë të 70% të biletës së trafikut urban, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës. Rrjedhimisht ditët e punës për paditëst te cilave ua ka aprovuar kompensimet per shpenzimet e udhetimit , të vërtetuara nga vet punëdhënësi, gjykata i ka shumëzuar me shumën prej 1 euro të parapara si në nenin 35 paragrafi 7 të KKAK-së, biletën e trafikut urban e ka llogaritur në vlerë prej 0.70 euro kthyesë per secilin prej paditësve apo në vlerë prej 70% te çmimit prej 1 euro , ashtu si ne precizim, të parapara si në nenin 35 paragrafi 5 të KKAK-së duke ia njohur shumën e gjykuar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

Andaj duke u nisur nga dispozitat ligjore të lart cekura të Kontratave Kolektive, si dhe gjendjes faktike, rezulton që kërkesëpadia e paditëseve është e bazuar, ku me ç’rast është detyruar e paditura që paditëseve të ua kompensoj secilës veç e veç shumat e gjykuara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa sa i përket pretendimeve te autorizuarit te te paditurës te

njëjta rezultuan se palët paditëse janë kompensuar për shujta ditore me Aktgjykimin C.nr....te datës 01.06.2021 e jo për kërkesat që janë objekt kontesti i kësaj çështje juridike.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore në shkallë prej 8% bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë me datë 04.04.2022 bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur t'i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449 dhe 452 të LPK-së lidhur me Rregulloren për Tarifat e Avokatëve e datës 18 mars 2017, lartësia e shpenzimeve i referohet 208.00€ për përpilimin e padisë për 5 paditës, ashtu siç i ka kërkuar i autorizuari paditësit në precizim si dhe taksën gjyqësore shumën prej 20.00€, në shumë të përgjithshme 498.00€ (katërqind e nëntëdhjetë e tetë euro).

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 143 dhe nenit 398 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHMË- DIVIZIONI CIVIL
C.619/21, me datë 15 Mars 2024

Gjyqtarja
Kreshnike Zymberi Beqiri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.